



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, të ndryshuar”
3. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”
4. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Ilir Xhakolli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ervin Bushati dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Sajmir Muçmataj - Drejtor Juridik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Madalena Koja – Juriste në Departamentin e Legjislacionit dhe Akteve Rregullatore në Kryeministri

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi disa çështje.

Së pari, kemi prezantimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, të ndryshuar”. Relatore e këtij projektligji është zonja Evis Kushi.

Së dyti, kemi projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Relatore e këtij projektligji është zonja Blerina Gjylameti.

Së treti, kemi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”. Relatore e këtij projektligji është zonja Blerina Gjylameti.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në komision zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Elton Haxhi.

Fillojmë me prezantimin, nga ana e zëvendësministrit, të projektligjit të parë “Për investimet e huaja”, të ndryshuar. Më pas fjalën e ka relatorja e komisionit për këtë projektligj.

Fjala për ju, zoti zëvendësministër.

Elton Haxhi – Faleminderit!

Në vazhdim të ndryshimit për afatet e veprimit, të cilin e kemi kryer kohë më parë, për investimet strategjike dhe për investimet e huaja, kërkohet një shtyrje e afateve të veprimit të ligjit nr. 7764 me një vit, deri më 31 dhjetor të vitit 2019. Kjo bëhet për arsyen se Ministria e Financave në hartimin e një ligji të integruar, që do të përfshijë edhe investimet strategjike dhe investimet e huaja, do të mundësojë një trajtim të njëjtë si të investitorëve të huaj, ashtu edhe të investitorëve vendas. Ky ligj është duke u hartuar dhe mendohet se do të miratohet brenda vitit 2019 për t'i pasur efektet e tij nga data 1 janar i vitit 2020. Për këtë arsye kërkohet shtyrja e afateve të veprimit të ligjit nr. 7764 “Për investimet e huaja”.

A të vazhdoj edhe me ndryshimet e tjera?

Erion Braçe – Jo, sepse do të dëgjojmë zonjën Kushi lidhur me këtë projektligj dhe më pas do të vazhdojmë me ligjet e tjera.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Projektligji që po shqyrtojmë sot propozon një ndryshim në ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, të ndryshuar, i cili ka në fokus mbrojtjen e posaçme shtetërore për garanci dhe siguri të shtuar juridike ndaj investimeve apo investorëve të huaj, të cilët investojnë në Shqipëri.

Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2010 miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e investimeve të huaja, me qëllim zgjidhjen e problematikave të evidentuara, siç ishin edhe konfliktet gjyqësore me palë të treta private, të cilat kishin ndikuar në shtimin e pasigurisë juridike të titujve të pronësisë, duke penguar realizimin e investimit. Sidoqoftë, një nga kufizimet e ligjit propozonte që mbrojtja e posaçme shtetërore të ishte e kufizuar në kohë deri në datën 31.12.2014, ndërsa ndryshimet e ligjit nr. 46/2017 e shtynin këtë afat deri në fund të vitit 2018.

Projektligji që po shqyrtojmë sot parashikon ndryshimin e pikës 1, të nenin 11/1 të ligjit, duke e shtyrë afatin e efektshmërisë së mbrojtjes së posaçme shtetërore nga 31 dhjetori i vitit 2018 deri më 31 dhjetor të vitit 2019. Ky ndryshim vjen pas ndryshimit të miratuar në tetor të këtij viti në ligjin për investimet strategjike, i cili zgjati afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesave për përfitimin e statusit “Investim/ investor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” deri më 31 dhjetor të vitit 2019. Zgjatja e afatit është parashikuar vetëm për një vit, sepse në të njëjtën kohë po punohet nga institucionet përgjegjëse për hartimin e një ligji të unifikuar dhe gjithëpërfshirës të investimeve të huaja dhe strategjike, në përputhje me rekomandimet e BERZH-it.

Në këtë drejtim dua të theksoj se vendi ynë ka adoptuar një legjislacion liberal për sa u takon investimeve të huaja në vend, i mbështetur në parimin e mosdiskriminimit ndërmjet investorëve vendas dhe të huaj. Ndryshe nga disa vende të rajonit, të cilat nuk e kanë një ligj të veçantë për investimet e huaja, siç është Kroacia apo Maqedonia, Shqipëria ka institucionalizuar një sërë mekanizmash mbrojtës për investorët.

Nga ana tjetër, edhe ndryshimet në vitet e fundit të politikave fiskale, të cilat janë fokusuar në tërheqjen e sa më shumë investimeve të huaja, ku mund të përmendim incentivimin fiskal për hotelet dhe resortet *brand name* me 4 dhe 5 vje, aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi të ardhurat në masën 5% për *software*-t dhe për çdo subjekt tjetër me të ardhura deri në 14 milionë lekë.

Megjithatë, çdo ndryshimi i ardhshëm i kornizës ligjore duhet të garantojë qartësi, transparencë dhe parashikueshmëri për çdo investor, që dëshiron të investojë në Shqipëri, të

cilët më pas do të ndikojnë në rritjen ekonomike, në diversifikimin, në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe rrjedhimisht do të mundësojnë investime të rëndësishme dhe punësim.

Në përfundim të fjalës sime, duke qenë se projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit, si dhe nëpërmjet miratimit të tij garantohet mbrojtja e posaçme për investimet e huaja, i propozoj komisionit të votojë pro kalimit të tij në seancë plenare.

Gjithashtu, duke pasur parasysh që ligji duhet të miratohet brenda muajit dhjetor të këtij viti, unë propozoj ndryshimin e nenit 2 të projektligjit për hyrjen në fuqi të tij menjëherë.

Së fundi, zoti kryetar, kam një pyetje të shkurtër. Në cilën fazë ndodhet hartimi i projektligjit, për të cilin fola pak më parë, në lidhje me investimet e huaja? A është e mjaftueshme koha deri në fund të vitit 2019, që ligji të hartohet dhe të kalojë të gjitha procedurat e tjera, madje edhe miratimin në Kuvendin e Shqipërisë?

Faleminderit!

Elton Haxhi – Puna për ligjin e integruar të investimeve ka filluar që në vitin 2017. Është një ligj që po përgatitet me asistencë të huaj, konkretisht IFC-ja po asiston Ministrinë e Financave për hartimin e këtij ligji. Gjithashtu, është bërë një dokument paraprak, i cili është konsultuar në një tryezë edhe me palët e interesuara, ku janë marrë disa komente, të cilat janë duke u reflektuar, por ende nuk ka dalë një draft zyrtar, që të qarkullohet për mendim. Mendohet se në fillim të vitit 2019 do të dalë drafti zyrtar, i cili do të qarkullohet për mendim dhe konsultim publik.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka. A ka diskutime lidhur me këtë projektligj? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, të ndryshuar”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja Kushi, propozimi juaj për nenin 2 kërkon që t'i merret leje Presidentit të Republikës ose më saktë ai duhet të japë pëlqimin për këtë gjë. Unë jam në dijeni se Presidenti i Republikës është shumë i zënë me punë dhe nuk besoj se do ta japë këtë gjë.

Evis Kushi – Duhet të bëjmë një përpjekje.

Erion Braçe – Në rregull! Të shpresojmë se do ta ketë axhendën e lirë.

Atëherë, t'i dërgohet një shkresë Presidentit të Republikës, duke i shpjeguar problematikën. Presidenti i ka mbështetur gjithmonë investimet e huaja, kështu që besoj se do ta gjejë kohën edhe për këtë gjë.

E hedhim në votë nenin 2, me propozimin që ka bërë zonja Kushi dhe, në rast se Presidenti i Republikës nuk jep pëlqimin për hyrjen në fuqi menjëherë, atëherë të mbete në fuqi kështu siç është.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votë projektligjin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”
2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Ilir Xhakolli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ervin Bushati dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Sajmir Muçmataj - Drejtor Juridik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Madalena Koja – Juriste në Departamentin e Legjislacionit dhe Akteve Rregullatorë në Kryeministri

Erion Braçe – Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

Elton Haxhi – Faleminderit!

Të dyja shtesat konsistojnë në të njëjtën çështje dhe të dyja këto projektligje, projektligji nr. 55/2015 edhe projektligji nr. 9374, kanë të njëjtin përkufizim. Kjo është një nismë ligjore e ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave, duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë e qeverisë për të luftuar kriminalitetin në vend, duke shmangur me çdo rast dhe me çdo mjet krijimin e lehtësirave për subjektet përfituese të dënuar penalisht kur ka të dhëna dhe provohet se subjekti përfitues i ndihmës apo mbështetjes është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Erion Braçe – Më falni, por jemi te ligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Elton Haxhi – Po, është i njëjti përcaktim që përjashton këtë kategori subjektesh nga përftimi i statusit si investitor strategjik, por edhe nga ndihma shtetërore. Siç e përmenda më sipër, bëhet fjalë për një grup subjektesh, të cilët kanë pasur një vendim gjyqësor të formës së prerë për pjesëmarrje në një grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste, janë të dënuar për korrupsion, për mashtrim, për pastrim parash dhe financim terrorizmi, janë të dënuar për vepra me qëllime terroriste, të lidhura me veprimtari terroriste, nxitje, ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste, organizim, drejtim dhe financim i veprimtarisë së prodhimit ose shitjes së lëndëve narkotikëve, si dhe veprimtari të trafikut të narkotikëve, falsifikim, trafikimi i fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore. Përjashtohen jo vetëm subjektet, por edhe nëse në organet e tyre administrative, drejtuese, mbikëqyrëse të objektit përfitues ka persona të cilët janë dënuar me vendime të formës së prerë. Pra, për vërtetimin e pastërtisë së figurës së këtyre subjekteve kërkohet vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument i lëshuar nga autoriteti kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në këto pika. Ky rregullim i posaçëm do ta bëjë jo vetëm serioze, por edhe më konkrete luftën kundër krimit në Shqipëri në të gjitha mënyrat. Të dyja këto ndryshime, si në ligjin nr. 55/2015, ashtu edhe në ligjin nr. 9374, nuk kanë ndonjë efekt financiar në buxhetin e shtetit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Gjylameti, urdhëroni.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Këshilli i Ministrave në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të pikës 1 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, ka propozuar projektligjet “Për një shtesë në ligjin nr. 9374 “Për ndihmën shtetërore” i ndryshuar” si dhe “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 “Për investime strategjike”, i ndryshuar”, të cilat ia ka paraqitur komisionit për miratim në Kuvendin e Shqipërisë në përputhje me nenin nr. 68 të Rregullores.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrton projektligjet në cilësinë e komisionit përgjegjës bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Këto dy projektligje së bashku me ndryshimet e propozuara në ligjin “Për prokurimin publik”, si dhe në ligjin “Për turizmin”, janë pjesë e paketës së ndryshimeve ligjore, që kanë si qëllim ndalimin e përfitimit të të mirave publike nga subjektet e dënuara për një sërë veprash të rënda penale, që lidhen me krimin e organizuar, trafikimin, terrorizmin dhe korrupsionin. Falë kësaj pakete dhe me hyrjen në fuqi të ndryshimeve do të ndalohet çdo lloj mundësie që këto kategori subjektesh, shoqëri tregtare, aksionare dhe përfaqësues të tyre të përfitojnë para nga taksapaguesit shqiptarë apo të përfitojnë mbështetje financiare nga fondet publike për ushtrimin e aktivitetit të tyre fitimprurës. Në depozitat e projektligjeve parashikohet që nuk mund të përfitojë statusin e investitorit strategjik apo të përfitojë ndihmë shtetërore asnjë kompani, që jo vetëm rezulton e dënuar si subjekt juridik, por edhe në rastet kur të dënuar rezultojnë administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit, ortakët apo aksionarët.

I njëjti ndalim do të aplikohet edhe për përfitimin e tenderëve publikë apo lehtësirave në fushën e turizmit.

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zhvillimin e këtij projektligji janë: Ministria përgjegjëse për Ekonominë, Komisioni për Ndihmën në Ekonomi dhe Financa, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve “AIDA” dhe Komiteti i Investimeve Strategjike.

Ndryshimet e propozuara janë në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Europian dhe standardet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për këtë arsye i propozoj anëtarëve të komisioni miratimin e këtyre dy projektligjeve, me dy ndryshimet në dispozitat përbërëse të tyre që lidhen me teknikën legjislative si më poshtë:

Në projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015 “Për investime strategjike” i ndryshuar”, shkronja “b” duhet të renditet para shkronjës “a”.

Për sa i përket një elementi tjetër që vjen në formën e pyetjes dhe më pas me sqarimin që do të kemi për ndryshimin e dytë që duhet bërë te pika 1, pas shkronjës “e”. Pyetja që kam është, në projektligj ju i referoheni diskutimit për ndihmën shtetërore që nuk do të marrë asnjë kompani që rezulton e dënuar si subjekt juridik, ndërkohë nëse shikojmë pas pikës 1, ku shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “Përfshihet nga përfitimi i statusit subjekt investues strategjik, kur ka të dhëna që subjekti është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme”. Këtu u referoheni veprave penale të përfaqësuesve të kompanisë, të aksionarëve, drejtuesve dhe administratorëve, duke i renditur me radhë të gjithë. Dua të di, a keni ndalesa si për pjesën e kompanive po ashtu edhe për drejtuesit apo këto ndalesa janë vetëm për drejtuesit, aksionarët dhe administratorët? Nëse e keni edhe për kompanitë, atëherë do të duhet që në pikën 1/1 t’u referohemi veprave penale për personat juridik dhe jo vetëm për personat fizik.

Erion Braçe – Po, urdhëroni!

Specialist – Do t’ju sqarojë përfaqësuesja nga Departamenti Rregullator i Kryeministrit.

Madalena Agoja – Jam juriste në Departamentin Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri.

Ndryshimet konsistojnë në përjashtimin e personave juridikë nga përfitimi i fondeve publike apo i kontratave publike, por edhe të personave individ brenda personave juridikë me cilësinë e administratorit, aksionarit dhe përfaqësuesit ligjor, pra me fuqi vendimmarrëse brenda personit juridik.

Në mënyrën se si është formuluar, po i referohem draftit që ka ndryshuar në Komisionin e Ligjeve, ku ne ishim javën e kaluar, ku thuhet: “Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit “investitor në sektor strategjik”, apo në procedurat e asistuar dhe procedurat e veçanta, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprave penale të mëposhtme”, dhe janë të listuara njëra pas tjetrës. Këtu bëhet fjalë për personin juridik dhe për individin brenda personit juridik. Kur flasim për subjekt i referohemi përkufizimit që vetë ligji i ka dhënë më lart. Pra, subjekti është vetë personi juridik që aplikon për të përfituar në statusin e investitorit strategjik, në rastin e ligjit “Për investime strategjike”, apo për të përfituar përfitime të tjera në kuadër të ligjit “Për ndihmën shtetërore”.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka dhënë opinion Komisioni i Ligjeve për këtë projektligj?

Blerina Gjylameti – Po ka dhënë.

Erion Braçe – Nëse ka dhënë mendim Komisioni i Ligjeve, atëherë dakord, sepse ai është komision i specializuar.

Blerina Gjylameti – Por, do të duhet të ulen ekspertët e komisioni tonë së bashku me ekspertët e ministrisë që të definojnë pjesën e shqetësimeve që ngrita, e njëjta gjë është edhe për Komisionin e Ligjeve.

Erion Braçe – A ka bërë propozime Komisioni i Ligjeve?

Blerina Gjylameti – Nuk kanë bërë një propozim, por kanë bërë disa ndryshime që nuk janë reflektuar këtu.

Erion Braçe – Ndryshimet që ka propozuar Komisioni i Ligjeve të reflektohen aty dhe të njësohen draftet e të dyja komisioneve e të ecim përpara.

A ka pyetje apo diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votim. Hedhim në votim projektligjin “Për investime strategjike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Me ndryshimet e propozuara nga zonja Gjylameti dhe të konsultuara me Komisionin e Ligjeve.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hyrja në fuqi a do të jetë njësoj si rasti i zonjës?

Blerina Gjylameti – Po, duhet të jetë njëlloj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se duhet të jemi në të njëjtën linjë

Erion Braçe – Nuk ka emergjencë datash, ndërsa atje skadon ligji prandaj.

Dakord.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja Gjylameti, së bashku me kryetarin e Komisionit të Ligjeve dhe me ekspertët e qeverisë të definoni përfundimisht përkufizimin që duhet.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2018, ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Ilir Xhakolli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ervin Bushati dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Sajmir Muçmataj - Drejtor Juridik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Madalena Koja – Juriste në Departamentin e Legjislacionit dhe Akteve Rregullatorë në Kryeministri

Erion Braçe – Kalojmë te projektligji “Për ndihmën shtetërore të ndryshuar”. Pak a shumë shpjegimet u dhanë dhe janë të njëjta.

Zonja Gjylameti, a keni ndonjë gjë për këtë ligj?

Atëherë kam unë një pyetje, edhe këtu duhet të reflektohet i njëjti ndryshim që bëtë te ligji i mëparshëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Atëherë mbetet në fuqi me të njëjtat problematika që lidhen me kryetarin e Komisionit të Ligjeve dhe përfaqësuesit e qeverisë.

Kalojmë në votimin e këtij projektligji.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja Gjylameti, do të doja që të definoni brenda ditës së sotme me qëllim që të hartohen procesverbalet që duhen për seancën plenare të ditës së enjte.

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi PRIFTI

